Kori i përzier i Selanikut u formua në vitin 1987, udhëhequr nga dirigjentja Mary Konstantinidou. Ky kor përbëhet nga 50 anëtarë të moshave 20-40 vjeç, muzikantë ose studentë të muzikës dhe mbulon një gamë të gjerë repertori duke përfshirë vepra nga periudha e rilindjes, periudha klasike dhe romantike, vepra nga muzika bashkëkohore, oratorio dhe mesha, opera dhe mjuzikle, vepra bizantine, muzikë dhe kompozitorë grek. Kori i përzier i Selanikut ka marrë pjesë shumë herë në Festivalin Dimitria, në Sallën e Koncerteve të Athinës dhe Selanikut, në Operën Kombëtare Greke dhe Teatrin Antik Herod Atticus, në Festivalin Grek të Athinës dhe Ditët Ndërkombëtare të Muzikës të Selanikut, në Teatrin Antik të Efessos, në bashkëpunim me orkestra shtetërore greke dhe të huaja në Opera dhe Oratorio. Ky kor ka mbajtur shumë koncerte në Spanjë, Romë, Vjenë, Hungari, Pragë, Londër, Wallës, Finlandë dhe Turqi, ku është vlerësuar me medalje ari, argjendi dhe bronzi në konkurset ndërkombëtare të Athinës, Romës dhe Llanngollen. Gjatë vitit 1997 kori ka marrë pjesë në kryeqytetin kulturor të Europës me shumë koncerte të shfaqjeve të para të kompozitorëve bashkëkohorë nga Greqia dhe jashtë vendit, prodhime televizive dhe radiofonike dhe gjatë vitit 2000 ka marrë pjesë në kryeqytetin kulturor të Pragës me vepra të kompozitorëve çek. Që nga viti 1993 ky kor bashkëpunon me Orkestrën Simfonike të Bashkisë së Selanikut dhe me Orkestrat shtetërore të Athinës dhe Selanikut. Gjatë viteve 2000-2008 kori ka marrë pjesë në 18 produksione operistike në Megaron Music Hall të Selanikut. Si pjesëmarrës në Olimpiadën Kulturore 2004, kori u mbështetet nga Ministria e Kulturës.

Mary Konstantinidou ka lindur në Selanik dhe është diplomuar në Konservatorin Shtetëror të Selanikut. Ajo studioi me z. Erdei në Hungari dhe z. Titner në Pragë. Ka pasur shumë koncerte në Greqi, SHBA, Kanada, Spanjë, Stokholm, Pragë, Vjenë dhe Budapest. Ajo është dirigjente e Korit të përzier të Selanikut që nga themelimi i tij.

MIXED CHOIR OF THESSALONIKI

Mixed Choir of Thessaloniki was formed in 1987 under having Mary Konstantinidou it's conductor. It consist of 50 members 20-40 years of age, musicians or students of music and covers wide range of repertoire including works from Renaissance, Classical and Romantic period, works from Contemporary music, Oratorios, and Messes, Operas and Musicals, works of Byzantine music and Greek composers. Mixed Choir of Thessaloniki has participated many times, to the Dimitria Festival, to the Athen's and Thessaloniki's Concert Hall, to the Greek National Opera and Herod Atticus Ancient Theater, to the Greek Festival of Athens and International Music Days of Thessaloniki, to the Ancient Theater of Efessos, cooperating with Greek and Foreign State Orchestras in Operas and Oratorios. Mixed Choir of Thessaloniki has a lot of concerts in Spain, Rome, Vienna, Hungary, Prague, London, Wallis, Finland and Turkey and was awarded with Gold, Silver and Bronze medals in International Competitions of Athens, Rome and Llanngollen. During 1997 the choir has participated to the Cultural Capital of Europe with many concerts of first performances of contemporary composers from Greece and abroad, TV and Radio productions and during 2000 has participated to the Prague Cultural Capital of Europe with works of Czech composers. Since 1993 Mixed Choir of Thessaloniki is cooperating with the Symphony Orchestra of Municipality of Thessaloniki and with the state Orchestras of Athens and Thessaloniki. During the years 2000-2008 the choir has participated in 18 opera productions in Megaron Music Hall of Thessaloniki and Opera of Thessaloniki. The Choir is supported by the Ministry of Culture participating to the Cultural Olympiad 2004. Mary Konstantinidou is born in Thessaloniki and graduated from the State Conservatory of Thessaloniki. She studied with Mr. Erdei in Hungary and Mr. Titner in Prague. She has a lot of concerts in Greece, U.S.A., Canada, Spain, Stockholm, Prague, Vienna and Budapest. She is the conductor of Mixed Choir of Thessaloniki since it's foundation.

KEJSI HAXHIJA, SOPRANO

Kejsi Haxhija, ka lindur në Tiranë më 27.09.2002. Që e vogël ka pasur pasion muzikën. Mësimet e para të kantos, i ka nisur në moshën 13 vjeçare dhe më pas konkuroi në liceun Artistik "Jordan Misia", Tiranë ku ndoqi studimet me pedagoge Zina Zdrava. Studimet e larta i vazhdon në Universitetin e Arteve viti I-rë Master me pedagoge Ulpiana Aliaj. Gjatë këtyre viteve ka marrë pjesë në disa masterclasse dhe konkurse brenda dhe jashtë vendit, ku është vlerësuar maksimalisht. Një ndër to International Moscow Music Competition, ku është vlerësuar me çmimin e 5-të. Gjithashtu, ka marrë pjesë në koncertet që janë zhvilluar në Universitetin e Arteve dhe në Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit, ku së fundmi ka debutuar në rolin e "Paminës" në operën "Flauti Magjik", ka qenë një bashkëpunim i Universitetit të Arteve dhe Orkestrës së Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit e cila u shfaq në Tiranë, Elbasan dhe Prishtinë.

Kejsi Haxhija is a soprano from Tirana, born on 27.09.2002. Her passion for music started at an early age, starting her canto lessons at only 13 years of age after which she competed in the artistic lyceum of Tirana "Jordan Misia" under the mentorship of Zina Zdrava. She is pursuing higher education at the Faculty of Arts with pedagogue Ulpiana Aliaj. During these years she has participated in a multitude of masterclasses and competitions in and out the country, returning with outstanding ratings such as the 5th prize at International Moscow Music Competition. She has also been part of concerts held at Faculty of Arts as well as The National Theatre of Opera and Ballet, the most recent she debuted on the role of "Pamina" in "Magic Flute", a collaboration between the two that was shown in Tirana, Elbasan and Prishtina.

SHINASI RAMADANI, BARITON | BARITONE

Shinasi Ramadani ka lindur më 12.07.1996 në Shkup , Maqedonia e Veriut. Ai është një solokëngëtar, i cili ka treguar interes për muzikë (posaçërisht për këndim) prej moshës dhjetë vjeç. Inkuadrimi i tij në botën e muzikës fillon kur ai ishte nxënës në shkollën e mesme të muzikës "Ilija Nikollovski - Luj" në Shkup , ku solokëndimin e kreu në klasën e profesor Mustafa Imeri. Ai i vazhdoi studimet në Fakultetin e muzikës në Shkup, në klasën e prof. Ana Durlovski.

Ai ka performuar në shumë koncerte, ndër to performanca më e spikatur ka qenë koncerti Kosta Trpkov ku marrin pjesë studentët e Universiteteve të muzikantëve në Republikën e Maqedonisë , ku u lavdërua me kritikë më të larta për performancën e tij. Nga viti 2022 është anëtar i korit të Operës Kombëtare në Shkup.

Shinasi Ramadani was born on 12.07.1996 in Skopje, North Macedonia. He is a solosinger, who has shown interest in music (especially singing) since the age of ten. His entry into the world of music started when he began studying at the high school of music "Ilija Nikollovski - Luj" in Skopje, where he also studied singing in the class of prof. Mustafa Imeri. He continued his studies at the Faculty of Music in Skopje, in the class of prof. Ana Durlovski. He has performed in many concerts, such as Kosta Trpkov concert, where students from the Universities of musicians in the Republic of Macedonia take part; there he was praised with the highest criticism for his performance. He is currently a member of the choir of the National Opera in Skopje.

HARRIS BAJRAKTARI, BARITON | BARITONE

Harris Bajraktari lindi në Stamboll- Turqi, shkollimin e mesëm dhe te lartë i kreu në Prishtinë në drejtimin e solokëndimit (bariton) në klasën e prof. Sanije Matoshi. Gjatë kohës së studimeve morri mësimet e kantos nga prof. Caroline Isabell Merz e cila ishte shtytsë e madhe në zhvillimin profesional të tij, po ashtu morri pjesë në punëtoritë me emrat e njohur të botës operistike si: Anna Pirozzi, Jean Bernard Thomas, Vito Brunetti, Francisco Araiza si dhe Giancarlo Monsalve. Ai është pjesë e Korit të Filharmonisë së Kosovës që nga viti 2019. Repertori muzikor konsiston me pjesë klasike dhe romantike. Morri vendin e parë në Ars Kosova Competition në vitin 2021, vendin e dytë në Medici International Music Competition 2021. I përzgjedhur nga Ramë Lahaj International Opera Festival si Young Generation Artist, ai ndjek punëtoritë dhe bashkpunimin me Mascarade Opera Studio (Florence, Italy). Në vitin 2022 debutoi në rolin e Dottore Grenvil - La Traviata në Operën e Kosovës dhe në vitin 2023 debutoi në rolin e Sempronios - Lo Speciale (i aranzhuar për bariton) në Operën e Kosovës.

Harris Bajraktari was born in Istanbul- Turkey, completed his secondary and higher education for solosinging (baritone) in Prishtina, in class of prof. Sanije Matoshi. During his studies, he took canto lessons from prof. Caroline Isabell Merz, who was a great impetus in his professional development, also participated in workshops with well-known names of the opera world such as: Anna Pirozzi, Jean Bernard Thomas, Vito Brunetti, Francisco Araiza and Giancarlo Monsalve.

He has been part of the Kosovo Philharmonic Choir since 2019. The musical repertoire consists of classical and romantic pieces. He took first price in Ars Kosova Competition in 2021, second price in Medici International Music Competition 2021. Selected by Ramë Lahaj International Opera Festival as Young Generation Artist, he attends workshops and collaboration with Mascarade Opera Studio(Florence, Italy). In 2022 he debuted in the role of Dr. Grenvil - La Traviata, and in 2023 he debuted in the role of Sempronio - Lo Speciale (arranged for baritone) at the Opera of Kosovo.

ISMET VEJSELI, TENOR

Ismet Vejseli, i lindur në Kumanovë më 11.04.1998, është një solo këngëtar i arrirë me një rrugëtim të jashtëzakonshëm. Shkollimin muzikor e filloi në klarinetë dhe solo këndim, duke vazhduar studimet në shkollën e mesme të muzikës Ilija Nikolovski- Luj në Shkup nën drejtimin e tenorit Mustafa Imeri. Gjatë shkollës së mesme, Ismeti mori çmime të shumta, të njëpasnjëshme në konkurse shtetërore dhe ndërkombëtare për solo këndim. Talenti i tij shkëlqeu dukshëm edhe në skenat ndërkombëtare, duke i dhënë atij vlerësime të shumta në festivale të shumta në vendet si Serbi, Itali, Rusi etj. Ismeti përfundoi arsimin e lartë në fakultetin e muzikës "Shën Kirili dhe Metodikë", në Shkup në klasën e sopranos së njohur Ana Durlovski. Pikat kryesore të karrierës së tij përfshijnë shfaqjet në Berlin, Gjermani, një recital në Tiranë, Shqipëri dhe një debutim mbresëlënës në Moskë, Rusi. Arritjet e Ismetit shtrihen edhe në këndimin në Kremlin dhe në Operën dhe Baletin Kombëtar të Shkupit, duke bërë histori si Opera e parë shqiptare në Maqedoni. Në vitin 2021, ai fitoi nderimet kryesore në garat ndërkombëtare në Rusi dhe Beograd. Ismeti u pranua në akademinë Concertante në Barcelonë të Spanjës, nën mentorimin e maestro Raul Gimenez. Ai është paraqitur edhe në Prishtina International Vocal Festival në Prishtinë dhe gjithashtu ka performuar me Filharmoninë e Kosovës në Tiranë. Karriera e Ismet Vejselit vazhdon të rritet, e shënuar me debutimin e tij në Nju Jork të SHBA-së dhe një paraqitje prestigjioze në festivalin Musikverein në Vjenë. Debutimi i tij në Operën Kombëtare Sllovaqe e pa atë të shkëlqejë në 13 opera me 65 shfaqje në vetëm 10 muaj. Talenti i jashtëzakonshëm dhe vlerësimi ndërkombëtar i Ismet Vejselit e forcojnë statusin e tij si një yll në ngritje në botën e solo këndimit.

Ismet Vejseli, born in Kumanovo on April 11, 1998, is an accomplished solo singer with a remarkable journey. He began his musical education in clarinet and solo singing, continuing his studies at the Ilija Nikolovski- Luj Music High School in Skopje under the guidance of tenor Mustafa Imeri. During high school, he garnered numerous awards, including consecutive wins at the Macedonian state competition for solo singing. His talent also shone on international stages, earning him accolades at festivals in Serbia and Italy. Ismeti pursued higher education at the St. Cyril and Methodius music faculty in Skopje under the tutelage of renowned soprano doc. Ana Durlovski. His career highlights include performances in Berlin, Germany, a recital in Tirana, Albania, and an impressive debut in Moscow, Russia. Ismeti's accomplishments extend to singing in the Kremlin and at the National Opera and Ballet of Skopje, making history as the first Albanian Opera in Macedonia. In 2021, he clinched top honors in international competitions in Russia and Belgrade. Notably, Ismeti was admitted to the Concertante academy in Barcelona, Spain, under the mentorship of maestro Raul Gimenez. He also graced the Pristina International Vocal Festival and performed with the Kosovo Philharmonic in Tirana. Ismet Vejseli's career continues to soar, marked by his debut in New York, USA, and a prestigious appearance at the Musikverein festival in Vienna. His recent tenure with the Slovak National Opera saw him excel in 13 operas with 65 performances in just 10 months. Ismet Vejseli's exceptional talent and international acclaim solidify his status as a rising star in the world of solo singing.

DEA XHEMAILI, MEXOSOPRANO | MEZZOSOPRANO

Me muzikë ka filluar të merret që nga moshë 4 vjeçare. Dea Xhemaili ka qenë qenë fituese e shumë festivaleve brenda dhe jashtë Kosovës; një ndër çmimet kryesore ka qenë ai në Modena, Itali fituese e çmimit grand prix. Mbaroi studimet në Fakultetin e Arteve dhe së fundmi përfundimin e studimeve master - drejtimi Solokëndim. Ajo ka marrë pjesë në shumë festivale garuese, master klase me profesor të ndryshëm dhe kam qenë fituese e disa çmimeve si: në garat ndërkombëtare "Ars Kosova" ka qenë fituese e çmimit të dytë në vitin 2015 ,fituese e çmimit të parë në vitin 2018 etj. Është anëtare aktive e Korit të Filharmonisë së Kosovës që prej vitit 2012. Për shumë vite ka qenë e angazhuar në institucione dhe festivale të ndryshme si: Menaxher i projektit në Festivalin Prishtina Kids, Asistente-mësuese muzike në grupin e fëmijëve Xixëllonjat, organizatore e shumë koncerteve dhe shfaqje muzikore. Që nga viti 2018 është pjesë e festivalit PrIVocalFest si bashkëpunëtoze e ngushtë e festivalit.

She started playing music at the age of four. Dea has been the winner of many festivals inside and outside Kosovo; one of the main awards was the one in Modena, Italy, winner of the grand prix award. She finished her studies at the Faculty of Arts and recently completed her master studies in Solo Singing. She has participated in many competition festivals, masterclasses with different professors and has won several prizes, such as: the international competitions Ars Kosova- winner of the second prize in 2015, winner of the first prize in 2018, etc. She is an active member of the Kosovo Philharmonic Choir since 2012. For many years she has been engaged in various institutions and festivals such as: Project Manager at the Prishtina Kids Festival, assistant teacher of the children's choir Xixëllonjat, organizer of many concerts and musical performances. Since 2018, she has been part of the PrIVocalFest as a close collaborator of the festival.

ADELINA PALOJA, SOPRANO

Adelina Paloja, sopranoja e mirënjohur, ndër zërat më të dalluar operistik të Kosovës, rrugëtimin e saj muzikor e nisi në piano në moshën 6-vjeçare. Studimet për kanto i përfundoi me rezultate të shkëlqyera në Fakultetin e Arteve në Prishtinë me prof. Merita Juniku, për të vazhduar studimet pasuniversitare në Universitetin e Shkupit në klasën e prof. Maria Muratovska-Naumovska. Ajo përfundoi studimet pasuniversitare si studente e dalluar me nderime të larta Summa Cum Laude. Gjatë gjithë rrugëtimin të saj akademik, Adelina fitoi vazhdimisht nderime të larta dhe çmime të shumta të para në konkurset e solo këngëtarëve lirik. Ajo iu bashkua Filharmonisë së Kosovës në vitin 2009, duke performuar rregullisht si soliste. Repertori mbresëlënës i Adelina's përfshin role ikonë si Rusalka nga Antonin Dvorák, Violetta në La Traviata nga G. Verdi, Fiordiligi Cosi fan tutte nga W. A. Mozart etj. Ajo ka bashkëpunuar me dirigjentë të shquar dhe ka performuar në festivale dhe skena ndërkombëtare në vende të tilla si Francë, Itali, Shqipëri, Suedi, Maqedoni, Bullgari, Emiratet e Bashkuara Arabe - Abu Dhabi, Mbretëria e Bashkuar, Holandë, Greqi. Këtë vit ajo u specializua në një vit akademik në tekniken e interpretimit, specialim në bel canto në Filharmoninë Ettore Pizzoli me Maestro Carmen SANTORO. Udhëtimi i jashtëzakonshëm i Adelina Palojes e ka çuar atë të performojë në vende ikonike si Vatikani dhe Panteon në Romë, së bashku me Korin Ndërkombëtar të Operas dhe Orkestrën Sinfonica Romana. Ajo ka kontribuar edhe në menaxhimin artistik të Filharmonisë së Kosovës. Është ligjëruese në Fakultetin e Arteve, Departamentin e Artit Muzikor të Universitetit Haxhi Zeka të Pejës dhe në Universitetin e Prishtinës, ku ligjëron lëndën kryesore të solo këndimit.

Adelina Paloja, well-known soprano, among the most distinguished operatic voices of Kosovo, began her musical journey on the piano at the age of 6. She completed her singing studies with excellent results at the Faculty of Arts in Pristina with prof. Merita Juniku, to continue her postgraduate studies at the University of Skopje in the class of prof. Maria Muratovska- Naumovska. She completed her postgraduate studies as a distinguished student with high honors Summa Cum Laude. Throughout her academic journey, Adelina consistently earned to honors and numerous first prizes in lyrical solo singing competitions. She joined the Kosovo Philharmonic in 2009, regularly performing as a soloist. Adelina's impressive repertoire includes iconic roles like Rusalka by Antonin Dvorák and Violetta in La Traviata by G. Verdi, Fiordiligi Cosi fan tutte by W. A. Mozart etc. She's collaborated with esteemed conductors and graced international festivals and stages in countries such as France, Italy, Germany, Albania, Sweden, Macedonia, Bulgaria, the United Arab Emirates - Abu Dhabi, the United Kingdom - England, the Netherlands, Greece. In addition to her performing career, Adelina has broadened her expertise through specialized training in bel canto and masterclasses with luminaries like Renatta SCOTTO. Paloja's remarkable journey has led her to perform at iconic venues like the Vatican and the Pantheon in Rome, alongside the International Opera Choir and Orchestra Sinfonica Romana. She also contributed to the artistic management of the Kosovo Philharmonic. She is a lecturer at the Faculty of Arts, Department of Musical Art of the University Haxhi Zeka of Peja and the University of Pristina, where she teaches the main subject of Solo singing. Paloja's dedication to the world of opera and her achievements make her a prominent figure in Kosovo's musical landscape.

ELONA SADIKU, SOPRANO

Shkollën fillore dhe të mesme të muzikës i përfundoi në Gjilan. Diplomoi në Universitetin "Hasan Prishtina", në Fakultetin e Arteve, Dega e Arteve Muzikore, drejtimi Solokëndim. Qysh në moshë të hershme dallohet talenti i saj për këndim, ku për herë të parë, për ta përfaqësuar shtetin e Kosovës udhëtoi në Festivalin Ndërkombëtar IFCL në Gjermani, Belgjikë, Senegal, Kazakistan e në Rumani, aty ku rrëmbeu medaljen e bronzë si soliste nga shumë shtete pjesëmarrëse nga e gjithë bota. Pothuajse që dy vite ajo është pjesëtare e Korit të Filharmonisë së Kosovës duke performuar shumë vepra vokale e vokalo-instrumentale. Elona u paraqit si soliste në shumë koncerte kombëtare të organizuara nga Opera e Kosovës, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, etj., si dhe ato ndërkombëtare, ku veçohet performanca e saj solistike në sallën e Filharmonisë së Berlinit së bashku me korin Siparantum. Ajo është fituese e garave të solokëndimit "Stojan Stojanov Gancev" 2022 në Zagreb, Kroaci. Përveç këndimit Elona fitoi çmimin e parë në garat e solfezhos ArsKosova si dhe performoi në shumë koncerte në instrumentin e saj të dashur pianon për vite me rradhë e poashtu kompozoi shumë këngë për fëmijë.

She completed primary and secondary music school in Gjilan. Graduated from "Hasan Prishtina"; University, at the Faculty of Arts, Department of Musical Arts, majoring in Solo Singing. From an early age, her talent for singing was noticed, where for the first time, to represent the state of Kosovo, she traveled to the International Festival of Language and Culture in Germany, Belgium, Senegal, Kazakhstan and Romania, where she won the bronze medal as soloists from many participating countries from around the world. For almost two years, she has been a member of the Kosovo Philharmonic Choir, performing many vocal and vocal-instrumental pieces. Elona appeared as a soloist in many national concerts organized by the Kosovo Opera, the Ministry of Culture, Youth and Sports, etc., as well as international ones, as the solo performance in the Berlin Philharmonic Hall together with the Siparantum choir. She is the winner of the solo singing competition "Stojan Stojanov Gancev", 2022 in Zagreb, Croatia. Except singing, Elona won the first prize in the "ArsKosova", solfeggio competitions and performed in many concerts on her beloved instrument, piano, for many years and also composed many children's songs.

ANSAMBLI VOKAL ATTACCA VOCAL ENSEMBLE

Ansambli ATTACCA është themeluar në vitin 2012, me iniciativë të kompozitorit dhe dirigjentit Hajrullah Syla. Ky ansambël përbëhet nga 16 vokalist profesionist dhe korepetitor. Ansambli Attacca koncertin premierë e realizoi në muajin Prill të vitit 2012, ku u paraqit me një program, që përfshiu epoka të ndryshme stilistike, duke filluar nga Renesanca e deri te ato moderne- bashkëkohore, përfshirë kompozitorët shqiptarë dhe ata të huaj. Deri më tani Ansambli Attacca, që nga themelimi i tij ka pasur disa koncerte solistike të suksesshme në vendin tonë. Në nëntor të vitit 2012 ka qenë i ftuar nga Filharmonia e Kosovës, në hapjen e koncertit të rregullt të Korit të Filharmonisë së Kosovës, gjithashtu ka pasur edhe bashkëpunime të tjera po me këtë institucion. Ansambli Attacca është paraqitur në Festivale të ndryshme në Kosovë si :Re Musica, DAM Festival, PrIVocalFest etj. poashtu ka qenë i ftuar edhe nga disa Festivale ndërkombëtare si: Skopje Summer-Maqedoni, Primorsko-Bullgari etj..

Attacca Ensemble was formed in 2012, with the initiative of composer Hajrullah Syla. This ensemble consists of 16 professional vocalists and an accompanist. Attacca Ensemble had it's premiere concert on April of 2012, where they presented a program of various stylistic eras, ranging from the Renaissance to Modern ones, including Albanian and foreigner composers. So far, the Attacca Ensemble has had several successful solo concerts in our country. In November of 2012, the Attacca Ensemble was invited by the Kosovo Philharmonic to open the regular concert of the Kosovo Philharmonic Choir, which was followed by other collaborations in the next years. Attacca Ensemble was also presented in various festivals around Kosovo, such as: Re Musica, DAM Festival, PrIVocalFest etc. it also has had several invitations by international Festivals like: Summer Skopje-Macedonia, Primorsko-Bulgaria etc..

HAJRULLAH SYLA, DIRIGJENT | CONDUCTOR

Në vitin 2014 Syla përfundoi studimet në kompozim dhe në vitin 2017 përfundoi studimet për dirigjim pranë Universitetit të Prishtinës. Si kompozitor dhe dirigjent është paraqitur në vende të ndryshme si: Kosovë, Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Gjermani, Francë, Itali, Bullgari, Turqi, Belgjikë, Lituani, Britani e Madhe, USA etj. Ai gjithashtu është paraqitur si dirigjent me Orkestra të ndryshme si: Filharmoninë e Kosovës, Orkestrën e të Rinjëve të Kosovës, Orkestrën kamertale "Rexho Mulliqi", Orkestrën Harkore "Tadenus" etj.. Në shkurt të vitit 2021 Syla mbajti një koncert tejet të suksesshëm me Ansamblin Vokal të Filharmonisë së Kosovës, ku pas kësaj paraqitje Syla morri ftesë nga selektuesit e festivali prestigjioz "Vera e Ohrit", festival ky që këtë vit shënoi edicionin e 61-të, Syla në këtë festival u paraqit si dirigjent me Korin e Filharmonisë së Kosovës ku morri vlerësime të larta si një koncert shumë i suksesshëm nga kritika e festivalit. Syla është fitues i disa çmimeve brenda dhe jashtë vendit si: Ministria e Kulturë për veprat Fog in the Forest 2021, Ubi Caritas 2020; Duo for Violin and Cello, Druskomanija 2018 në Lituani; në vitin 2015 ai ishte fitues i Berlin Auditions 2015 që organizohet nga Spectrum Concerts, ku në vitin 2016 dy nga veprat e Sylës janë interpretuar në Berliner Kammermusiksaal, Fantasia për solo klarinet in Bb dhe Lotë e Nënës për ansambël kamertal etj. Ai ka mbajtur masterklase me dirigjentë të njohur si: Toshio Yanagisawa, Rene Gulikers, John Armstrong, Nathalie Marin etj.. gjithashtu ka qenë pjesëmarrës në ACDA Konferencë në USA, EAS Konferencë në Lituani dhe është fitues i dy bursave nga MM-University - USA. Në vitin 2018 Syla themeloi festivalin e muzikës vokale PrIVocalFest, që njëherit është festivali i vetëm që i dedikohet muzikës vokale në Kosovë. Në vitin 2012 Syla ka formuar Ansamblin vokal Attacca, i përbërë nga 16 vokalist. Që nga viti 2012 ai kryen detyrën e asistent - dirigjentit në Filharmoninë e Kosovës, gjithashtu nga viti 2019 është pjesë e Orkestrës Frymore të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

In 2014 Syla completed his studies in composition and in 2017 he completed his studies for conducting at the University of Prishtina. He has performed as a composer and conductor in various countries such as: Kosovo, Albania, Northern Macedonia, Germany, France, Italy, Bulgaria, Turkey, Belgium, Lithuania, Great Britain, USA, etc. He has also appeared as a conductor with various orchestras such as: Kosovo Philharmonic, Kosovo Youth Orchestra, "Rexho Mulliqi" Chamber Orchestra, "Tadenus" String Orchestra etc.. In February 2021 Syla held a very successful concert with the Vocal Ensemble of the Kosovo Philharmonic, where after this performance Syla received an invitation from the selectors of the prestigious festival "Ohrid Summer", a festival that this year marked its 61st edition. Syla in this festival was presented as a conductor with the Kosovo Philharmonic Choir where he received high praise as a very successful concert by the critics of the festival. Syla is the winner of several awards at home and abroad such as Ministry of Culture in Kosovo for works: Fog in the Forest 2021, Ubi Caritas 2020; Duo for Violin and Cello, Druskomanija 2018 in Lithuania; in 2015 he was the winner of the Berlin Auditions 2015 organized by Spectrum Concerts, where in 2016 two of Syla's works were performed at the Berliner Kammermusiksaal, Fantasia for solo clarinet in Bb and Mother's Tears for chamber ensemble etc. He has held masterclasses with well-known conductors such as: Toshio Yanagisawa, Rene Gulikers, John Armstrong, Nathalie Marin etc.. he has also participated in ACDA Conference in USA, EAS Conference in Lithuania and is the winner of two scholarships from MM-University - USA. In 2018 Syla founded the vocal music festival PrIVocalFest, which is also the only festival dedicated to vocal music in Kosovo. In 2012 Syla formed the Attacca vocal ensemble, consisting of 16 vocalists. Since 2012 he has been working as an assistant conductor at the Kosovo Philharmonic also, from 2019 Syla is part of the Wind Orchestra of the Kosovo Security Force.

MELOS BUZA, PIANO

U lind më 12 dhjetor 1988. Mësimet e para të pianos i filloi në Gjakovë. Vazhdoi shkollimin në shkollën e mesme të muzikës "Prenk Jakova" në Prishtinë, në klasën e prof. Mišbah Kaçamaku. Pas shkollës së mesme ai vazhdoi studimet për piano në Norvegji me prof. Eva Helene Schwartz dhe prof. Jiři Hlinka në Barrat-Due Musikkinstitutt, Oslo. Studimet bachelor dhe master I përfundoi në UP, Fakulteti i Arteve-DAM në klasën e prof. Lejla Pula. Ai është pjesëmarrës i rregullt i skenës koncertale, festivaleve dhe aktiviteteve të tjera të muzikës klasike në Prishtinë.

Melos Buza was born on December 12, 1988. He started his first piano lessons in Gjakova. He continued his education at the high school of music "Prenk Jakova"; in Pristina, in the class of prof. Misbah Kaçamak. After high school he continued his piano studies in Norway with prof. Eva Helene Schwartz and prof. Jiři Hlinka at Barrat-Due Musikk institutt, Oslo. He completed his bachelor and master studies at UP, Faculty of Arts-DAM in the class of prof. Lejla Pula. He is a regular participant of the concert scene, festivals and other classical music activities in Pristina.

ZOYA PETROVA, SOPRANO

Zoya Petrova, soprano- soliste e operas dhe kompozitore. Soliste e Operës së Bratisllavës, Sllovakia. Soliste e ftuar e Teatrit Shtetëror Košice, Sllovakia. Në vitin 2022, Zoya këndoi rolin e Papagena-s në produksionin e Flautit Magjik në Schaffhausen, Zvicër. Në vitin 2022, Zoya Petrova ka interpretuar rolin e Frasquita në operën Carmen, në SND Opera, Bratisllavë; rolin e nënës së Lucias nga opera Peter and Lucia e Miro Bázlik si dhe rolin e Morenës në operën Svätopluk. Në vitin 2023 Zoya këndoi rolin e Mbretëreshës së Natës në Teatrin Shtetëror Košice në Sllovakia. Në vitin 2023, do të këndojë rolin e Brigitte nga opera Iolanta e P. Tchaikovsky në një shfaqje koncertesh në Filarmoninë e Bratisllavës. Zoya është pjesëmarrëse në festivale të tilla ndërkombëtare si: Festival Im. Bogusława Kaczynskiego (Poloni); Allegretto Žilina (Sllovakia); Festivali Ndërkombëtar i Muzikës, Leos Janáček (Republika Çeke); Festivali Veror i Muzikës në Krynica-Zdroj (Poloni); Music Fest Perugia (Itali); Rencontres Artistiques (Francë). Zoya Petrova performoi në Azi në salla të tilla si: salla e qytetit të operës së Tokios (Japoni); Salla Simfonike në Osaka (Japoni); Teatri i madh i Shangaist Baoli (Kinë); Qendra e Artit Lotte në Seul (Koreja e Jugut). Zoya Petrova është laureate e konkurseve ndërkombëtare në vokalin akademik, ndër to: Konkursi Ndërkombëtar i Vokalit J. Kiepara (Poloni); Konkursi Ndërkombëtar Vokal me emrin Ada Sari (Poloni); Konkursi Ndërkombëtar i Muzikës me emrin A. Rossini CIMP (Itali); Konkursi Ndërkombëtar Vokal Mikuláš Schneider-Trnavský (Sllovakia); Konkursi ndërkombëtar muzikor Konkursi çek dhe sllovak në SHBA (SHBA); Zoya Petrova është gjithashtu laureate e garave ndërkombëtare të kompozimit, ndër to janë: The Oscar Reading International- Konkursi për interpretues dhe kompozitorë; Konkursi ndërkombëtar për interpretues dhe kompozitorë Romantizmi: Origjina dhe Horizontet; Konkursi Ndërkombëtar i Dunaevsky për Kompozitorë dhe Arranzhues. Veprat e kompozura të Zoyas u interpretuan nga Orkestra Kamertale e Zagrebit (Kroaci) dhe Orkestra Filharmonike Sllovene (Slloveni). Zoya Petrova ka qenë mysafire e shpesh në radio: Radio Slovenija 1 (Slloveni); Radio Devin (Sllovakia).

Zoya Petrova, an opera singer and composer. Soloist of the Bratislava Opera House, Slovakia. Guest soloist of the Košice State Theater, Slovakia. In 2022 Zoya sang the role of Papagena in the production of The Magic Flute in Schaffhausen, Switzerland. In 2022 Zoya Petrova has performed at SND Opera in Bratislava the role of Frasquita in Carmen, the role of Lucia's Mother from Miro Bázlik's opera Peter and Lucia as well as Morena role in Svätopluk opera. In 2023 Zoya sang the role of Queen of the Night at the State Theater Košice in Slovakia. In 2023 Zoya will sing the role of Brigitte from P. Tchaikovsky's opera Iolanta in a concert performance at the Bratislava Philharmonic. Zoya is a participant of such international festivals as: Festival im. Bogusława Kaczynskiego (Poland); Allegretto Žilina (Slovakia); The Leos Janáček International Music Festival (Czech Republic); Summer Music Festival in Krynica-Zdroj (Poland); Music Fest Perugia (Italy); Rencontres Artistiques (France). Zoya Petrova performed in Asia in such halls as: Tokyo opera city hall (Japan); The Symphony hall in Osaka (Japan); Shanghai Baoli grand theater (China); The Lotte Art Center in Seoul (South Korea). Zoya Petrova is a laureate of international competitions in academic vocal, among them: J. Kiepara International Vocal Competition (Poland); International Vocal Competition named after Ada Sari (Poland); International Music Competition named after A. Rossini CIMP (Italy); Mikuláš Schneider-Trnavský International Vocal Competition (Slovakia); International music competition "Czech and Slovak contest in USA"; Zoya Petrova is also a laureate of international composition competitions, among them are: The Oscar Reading International Competition for Performers and Composers; The Romanticism: Origins and Horizons International Competition for Performers and Composers; the Dunaevsky International Competition for Composers and Arrangers. The composer's works of Zoya were performed by Zagreb Chamber Orchestra (Croatia) and the Slovenian Philharmonic Orchestra (Slovenia). Zoya Petrova has been a frequent guest on the radio: Radio Slovenija 1 (Slovenia); Radio Devin (Slovakia).

ANDI DURAKU, PIANO

Andi Duraku ka lindur në Gjakovë, ku dhe filloi mësimet për piano në shkollën e muzikës "Prenk Jakova" në Gjakovë, në klasën e prof. Besim Qorri. Studimet Bachelor dhe Master i kreu në Universitetin e Prishtinës në klasën e prof. Lejla Pula. Duraku është fitues i çmimeve në konkurse të shumta, ndër to: çmimi Grand Prix në konkursin Pianisti i Ri (2012); çmimi absolut dhe Grand Prix në garën Ars Kosova (2017); çmimi në audicionin e Berlinit- një koncert në sallën e Filharmonisë së Berlinit si solist (2016), çmimi special në festivalin Chopin Piano Fest, ku fitoi mundësinë të performojë një recital në Bon të Gjermanisë; çmimi i dytë në konkursin muzikor Barleta, Itali, çmimet talenti muzikor, Virtuozitetit si dhe me një numër të madh paraqitjesh në skenën Kosovare e më gjerë ndër to, performanca e koncertit për piano e J.S.Bach në përcjelljen e orkestrës së festivalit Kamerferst (2017), dy performanca me orkestrën e Maqedonisë së Veriut si solist (2022), si dhe disa koncerte ku performoi si solist me ansamblin e Gjakovës. Së fundi është prezantuar me një recital në Cziffra festival në Budapest. Si dhe në kuadër të koncertit të përbashkët të fituesve të çmimit special në Berlin. Duraku ka performuar në: Gjermani, Zvicër, Francë, Turqi, Shqipëri, Maqedoninë e Veriut, Hungari dhe Itali. Ka mbajtur masterklasa me: Dmitry Bashkirov, Eldar Nebolsin, Giovanni Belluci, Jerome Granjon, Istvan Lajko, Christopher Hinterhuber, Stephan Möller, Janosz Ballasz etj. Aktualisht është mësimdhënës në shkollën e muzikës "Prenk Jakova" në Gjakovë, si dhe vazhdimisht bashkëpunon me Korin e Filharmonisë së Kosovës.

Andi Duraku was born in Gjakova, where he began his piano lessons at the music school "Prenk Jakova" in Gjakova, in the class of prof. Besim Qorri. He completed his Bachelor and Master studies at the University of Pristina in the class of prof. Lejla Pula. Duraku is a prize winner in numerous competitions, among them: the Grand Prix prize in the Pianisti i Ri competition (2012); absolute prize and Grand Prix in the Ars Kosova competition (2017); prize at the Berlin audition - a concert at the Berlin Philharmonic hall as a soloist (2016), special prize at the Chopin Piano Fest festival, where he won the opportunity to perform a recital in Bonn, Germany; the second prize in the music competition Barleta, Italy, the musical talent, virtuosity awards as well as with a large number of appearances on the Kosovar stage and beyond, including the performance of J.S. Bach's piano concerto accompanied by the orchestra of the Kamerferst festival (2017), two performances with the orchestra of North Macedonia as a soloist (2022), as well as several concerts where he performed as a soloist with the Gjakova ensemble. Recently he was presented with a recital at the Cziffra festival in Budapest. As well as within the joint concert of the winners of the special prize in Berlin. Duraku has performed in: Germany, Switzerland, France, Turkey, Albania, North Macedonia, Hungary and Italy. He held masterclasses with: Dmitry Bashkirov, Eldar Nebolsin, Giovanni Belluci, Jerome Granjon, Istvan Lajko, Christopher Hinterhuber, Stephan Möller, Janosz Ballasz, etc. He is currently a piano teacher at the music school "Prenk Jakova" in Gjakova, as well as constantly collaborating with the Choir of the Kosovo Philharmonic.

CEYLAN TACI, KËNGËTARE | SINGER - KANTAUTORE | SONGWRITER

E lindur në Bruksel, me origjinë shqiptare, Ceylan është e rrethuar nga kultura ballkanike që në fëmijëri. Nëna e saj i transmetoi asaj pasionin për të kënduar dhe për të treguar histori. Përveç rrënjëve të saj muzikore shqiptare, ajo eksploroj ritmet afrikane, xhazin dhe muzikën botërore. Ajo bashkëpunoi me muzikantë belg të skenës së xhazit dhe muzikës botërore. Dashuria e saj për ritmin pasqyrohet në kompozimet e saj, tekstet e saj në shqip, anglisht dhe turqisht zbulojnë një univers shumë personal. « La voix des Racines » / « Zëri Rrënjëve » është një koncert tregimtar, një zgjatim I «Kthehu në rrënjë », projekti i mëparshëm i artistes. Me këtë performancë, Ceylan përcjell audiencën në një hapësirë intime ku ngjall frikën, tabutë, kodet, zgjimin dhe dashurinë, ku e kaluara jehon në të tashmen: « këto histori janë ura mes të shkuarës dhe asaj që ndiej në të tashmen, por ato nuk janë specifike për mua, ato gjenerojnë emocione universale». Bashkëpunimet: Në Kosovë: Arbër Salihu, Drin Tashi, Alzan Gashi për FemArt Festival dhe Poetry for Power; Astrit Stafai: inçizimi i këngës «Rrënjë» (teksti dhe kompozimi nga Ceylan Taci, aranzhimet nga Astrit Stafai), dhe Festivali Ndërkombëtar i Muzikës Vokale në Prishtinë- PrIVocalFest 2023. Në Belgjikë: Stephan Pougain, Nicolas Hauzeur, Didier Laloy, Pascal Chardome, Marie-Sophie Talbot, Benoît Vanderstraten, Javier Breton, Chrystel Wautier, Raphaëlle Brochet, Mladen Mladenov, François Lourthie, Henri Greindl, Pascale Seydel, Benjamin Clément, Félix Zurstrassen.

Born in Brussels, of Albanian origin, Ceylan has been surrounded by the Balkan culture since her childhood. Her mother transmitted her the passion of singing and telling stories. In addition to her Albanian musical roots, she explored African rhythms, jazz, and world music. She collaborated with musicians of the Belgian jazz and world music scene. Her love for rhythm and groove is reflected in her compositions. Her lyrics in Albanian, English and Turkish reveal a very personal universe. «La voix des Racines» / «Zëri Rrënjëve» is a story telling concert, an extension of «Back to the Roots», previous project of the artist. With this performance, Ceylan conveys the audience to an intimate space where she evokes the fear, the taboos, the codes, the awakening and love, where the past echoes in the present: «these stories are bridges between the past and what I feel in the present, but they are not specific to me, they generate universal emotions». Collaboration: In Kosovo: Arbër Salihu, Drin Tashi, Alzan Gashi for FemArt Festival and Poetry for Power; Astrit Stafai: recording of the song «Rrënjë» (lyrics and composition by Ceylan Taci, arrangements by Astrit Stafai), and Prishtina International Vocal Festival- PrivocalFest 2023. In Belgium: Stephan Pougin, Nicolas Hauzeur, Didier Laloy, Pascal Chardome, Marie-Sophie Talbot, Benoît Vanderstraten, Javier Breton, Chrystel Wautier, Raphaëlle Brochet, Mladen Mladenov, François Lourthie, Henri Greindl, Pascale Seydel, Benjamin Clément, Félix Zurstrassen.

ASTRIT STAFAI, MULTIINSTRUMENTIST

Astrit Stafai rrjedhë nga një familje me traditë të kulturës, artit dhe muzikës. Kur jemi tek tradita atëherë duhet cekur që Astriti është i biri i kompozitorit të mirënjohur mbarëkombëtar prof. Enver Stafës si dhe artistes së madhe të kombat znj. Shahindere Bërlajolli-Stafa. Talenti i Astritit është zbuluar qysh në moshën e re ku është pa interesimi për instrumentet si piano, kitara dhe çiftelia që nga moshja 5 vjeçare, për të vazhduar më tej rrugëtimin e tij muzikor profesional si multiinstrumentist, profesor i muzikës, interpretues i jashtëzakonshëm, aranzhues etj. Astriti kreu shkollën e mesme të muzikës në Maqedoni për të vazhduar më pas studimet Bachelor dhe Master pranë fakultetit të Arteve-DAM në Prishtinë. Ai njihet si virtuoz i jashtëzakonshëm i instrumenteve me tela si dhe njohës i fushës së muzikës në përgjithësi, me një bagazh shumë të madh dhe të larmishëm. Poashtu duhet të theksohet se ai ka hapur një kapitull të ri sa i përket botës së instrumenteve për arsye se ka implementuar instrumentet e kulturave botërore duke i gërshetuar me ato shqiptare dhe duke sjell koncerte primere në skenën tonë artistike me instrumentet si lauta, buzuki, udi, kitara, etj. Aktualisht punon si profesor në fakultetin AAB, pastaj është bashkëpunëtor i Filharmonisë së Kosovës, poashtu bashkëpunëtor i Ansambllit Nacional në Maqedoninë e Veriut, gjithashtu dhe me Ansambllin Nacional të Kosovës, punon si instrumentist në televizion në orkestër dhe si aranzhues. Ka një numër shumë të madh të bashkëpunimeve, koncerteve, performancave, inçizimeve si ato lokale, regionale dhe internacionale. Gjatë karrierës së tij deri tani ka performuar me formacione të ndryshme muzikore nga ato: klasike, korale, orkestrale, miks orkestër etj, ka koncertuar në vende si: Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi, Kroaci, Francë, Dubai, Katar, Stamboll, Londër, Skotlandë etj.

Astrit Stafai comes from a family with a tradition of culture, art and music. When we are talking about tradition, it should be mentioned that Astriti is the son of the well-known nationwide composer Prof. Enver Stafa and the great artist of the nation Mrs. Shahindere Bërlajolli-Stafa. Astrit's talent was discovered at a young age, where he was interested in instruments such as the piano, guitar and çiftelia since the age of 5, to continue his professional musical journey as a multi-instrumentalist, music professor, exceptional performer, arranger etc. Astriti completed high school of music in Macedonia to continue his Bachelor and Master studies at the Faculty of Arts-DAM in Prishtina. He is known as an exceptional virtuoso of stringed instruments as well as a connoisseur of the field of music in general, with a very large and varied background. It should also be noted that he has opened a new chapter in the world of instruments for the reason that he has implemented the instruments of world cultures by interweaving them with Albanian ones and by bringing premiere concerts to our artistic scene with instruments such as the lute, bouzouki, and udi, guitar, etc. He currently works as a professor at the AAB faculty; he has collaborations with the Kosovo Philharmonic, also an associate of the National Ensemble in North Macedonia, National Ensemble of Kosovo, he works as an instrumentalist on television in the orchestra and as an arranger. There is a very large number of collaborations, concerts, performances, recordings as local, regional and international. During his career so far, he has performed with various musical formations: classical, choral, orchestral, mixed orchestra, etc., he has performed in countries such as: Kosovo, Albania, Macedonia, Montenegro, Croatia, France, Dubai, Qatar, Istanbul, London, Scotland, etc.

prishtina international
vocal festival



03rd → 07th Tetov
October 2018

1st
edition



prishtina international
vocal festival



7 - 10 October 2019

2nd
edition



prishtina international
vocal festival

online edition

06 - 10 October 2020

3rd
edition



prishtina international
vocal festival

26-29
OCTOBER 2021



4th edition

EDICIONI 5
5TH EDITION



PRI
VOCAL
FEST

06-12
TETOR
OCTOBER
2022



prishtina international
vocal festival

04-14
TETOR | OCTOBER
2023

6th EDITION

www.privocalfest.com





sponsorët | sponsors

**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe
Sportit e Republikës së Kosovës**
Ministry of Culture, Youth and Sports
of the Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Municipality of Prishtina

LK Production
Instituti Italian i Kulturës
Italian cultural institute

Pink Taxi
AMC

sponsorët medial | medial sponsors

RTV Dukagjini


Kultplus

partnerët e festivalit | festival partners

Filharmonia e Kosovës
Kosovo Philharmonic

Universiteti i Prishtinës
Universitu of Prishtina

Defy Them





www.privocalfest.com

email:

privocalfest@gmail.com

mob:

+38346122877

address:

Mahir Domi 17, II/6 - 10000
Prishtinë Kosovë



prishtina international
vocal festival